

Vendim nr. 289, datë 10.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 10.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (N) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **NIKOLIN KUJXHIJA** përfaqësuar nga avokat Andi Çuhadari, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-364 (29), datë 28.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 18, 33, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Shkodër, me vendimin nr.621, datë 04.09.1995, ka vendosur të kthejë në pronësi, në favor të Xh.B., një sipërfaqe prej 450 m², të ndodhur në lagjen “3 Heronjtë”. Po kështu, me këtë vendim komisioni ka vendosur t’i njihet atij pronësia në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e pronave ish pronarëve” (për efekt parablerje) një sipërfaqe prej 6450 m², nga të cilat 2450 m², e zënë nga ndërmarrja Rruga-Ura, ndërsa sipërfaqja 4000 m² është sipërfaqe ndërtimore të zëna me objekte nga Ndërmarrja Gjeologjike Shkodër. Me vdekjen e trashëgimlënësës kjo pronë është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të saj, kërkuesit Nikolin Kujxhija, J.K., M.K., Ç.K. në masën 1/4-ën pjesë, të cilët, nëpërmjet privatizimit, kanë blerë 7 objekte që ndodhen në këtë sipërfaqe. Disa nga objektet që janë privatizuar nga kërkuesi dhe bashkëpronarët e tjerë rezultojnë të zëna nga banorë të cilët jetojnë aty.

2. Lidhur me lirimin e këtyre ambienteve, kërkuesi ka ngritur kërkesëpadi rivendikimi ndaj banorëve rezidentë në objektet e pretenduara në pronësi të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke kërkuar lirimin dhe dorëzimin e objekteve dhe të truallit të zënë, bashkë me pagesën e qerasë për shfrytëzimin e këtyre objekteve.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin, nr. 104 (247), datë 22.01.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, lirimin e objekteve dhe detyrimin e banorëve për t’i paguar kërkuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë (si ndërhyrës kryesorë) qiranë e objekteve në përdorim. Ajo gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se prona objekt konflikti rezulton në pronësi të kërkuesit dhe të bashkëpronarëve të tij dhe posedimi i saj është bërë nga të paditurit pa titull pronësie. Gjithashtu, ajo gjykatë, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur mospranimin e shqyrtimit të kundërpadisë të paraqitur nga dy prej të paditurve ku kërkohet edhe anulimi i kontratës së shitblerjes të objekteve nga ana e kërkuesit. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur ankim vetëm 4 nga të paditurit.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 603, datë 09.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 104 (247), datë 22.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me ndryshimin se kërkuesi dhe ndërhyrësit kryesorë detyrohen që t’i paguajnë të paditurve S.V. dhe D.V., shpenzimet e bëra për sendin objekt gjykimi në shumën 489,749 lekë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë janë të drejta dhe duhet të mbeten në fuqi. Megjithatë, lidhur me një nga objektet e përshtatura për banesë, gjykata e apelit, pas çeljes së pjesshme të hetimit gjyqësor, ka argumentuar se të paditurit S.V. dhe D.V. e kanë poseduar objektin me një akt ligjor, me kontratë, dhe kanë kryer shpenzime për përshtatjen e objektit në banesë që duhet të kompensohen nga paditësit. Po kështu, ajo gjykatë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesve për vendimmarrjen për mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me argumentin se ndaj atij

vendimi nuk ishte ushtruar ankim i veçantë dhe, si i tillë, nuk mund të merrej në shqyrtim. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të paditurit S.V. dhe D.V.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-364 (29), datë 28.01.2025, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 603, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues. Ai kolegji ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga të paditurit përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Kolegji Civil ka arsyetuar se nga të dhënat e dosjes gjyqësore dhe referuar vendimmarrjeve të gjykatave të faktit nuk rezulton që të jetë hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme nëse në rastin konkret, gjendeshin ose jo përpara një ankandi për shitjen e shoqërive në likuidim e sipër, për të cilat nuk zbatohet e drejta e parablerjes për ish-pronarët e truallit, por kërkohet pjesëmarrja në ankand, sikundër për subjektet e tjera. Po kështu, lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të kundërpadisë nga gjykata e apelit, ai kolegji ka vlerësuar se në rastin kur gjykata vendos mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë në të njëjtin proces me padinë, për shkak se nuk plotësohen kushtet e koneksitetit me kërkesëpadinë, do të gjendeshin përpara një vendimi të ndërmjetëm të gjykatës. Ndaj këtij vendimi, argumenton ai kolegji, palët mund të ushtrojnë ankim së bashku me vendimin përfundimtar, për sa kohë neni 160 i KPC-së nuk sanksionon mundësinë e ankimit të veçantë, ndërkohë që të ushtrohet ankimi i veçantë ndaj vendimit të gjykatës, ai duhet të parashikohet në mënyrë taksative nga ligji. Për këto arsye, Kolegji Civil ka vlerësuar se interpretimi i bërë nga Gjykata e Apelit Shkodër, duke e cilësuar vendimmarrjen e ndërmjetme të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë si vendim për kthimin e akteve, konsiderohej jo i bazuar në rregullimet dhe frymën e ligjit procedural civil. Ai kolegji, duke marrë në konsideratë efektet e vendimit penal (lidhur me pushimin e një çështjeje penale për vërtetësinë e titullit të pronësisë) në procesin civil, si dhe faktin që në çështjen objekt gjykimi kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor për pushimin e çështjes, që në shkallë të ndryshme të gjykimit (shkallë e parë dhe apel) i janë atribuar shkaqe të ndryshme pushimi, ka konkluduar se duhet të jetë gjykata e apelit, e cila në vijim të shqyrtimit të plotë gjyqësor të çështjes në rigjykim të mund të vlerësojë efektet eventuale të kësaj vendimmarrjeje në gjykimin civil.

7. Në përfundim, Kolegji Civil ka lënë si detyra për gjykatën e apelit, që në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, duhet: i) të zhvillojë një hetim të plotë nëse në rastin konkret, gjendeshin ose jo përpara një ankandi për shitjen e shoqërive në likuidim e sipër, në raport me të drejtën e parablerjes së ish-pronarëve dhe të drejtat e tyre të pronësisë; ii) të vlerësojë vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë për kundërpadinë, sipas parashikimeve të nenit

160 të KPC; iii) të administrojë dhe të vlerësojë natyrën e vendimeve të gjykatave të faktit për pushimin e çështjes penale, nëse këto vendimmarrje kanë ose jo relevancë për çështjen objekt gjykimi; iv) të çmojë “provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre; v) të zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi të KPC-së.

8. Në datën 10.09.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj nuk ka analizuar dhe arsyetuar drejt përfundimet e provës së re, vendimit penal (të apelit) në kushtet kur kjo provë ka rezultuar determinante në kthimin e çështjes për rigjykim, si dhe duke tejkaluar kompetencën e saj të kontrollit të ligjshmërisë dhe duke shqyrtuar provat.

9.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë për të administruar prova të reja në gjykim (2 vendime penale të vitit 2023), të cilat nuk i janë komunikuar atij, por edhe moskalimi për shqyrtim i tyre bashkë me rekursin në seancë gjyqësore përbën cenim të parimit të sigurisë juridike dhe atij *res judicata*. Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti se referuar nenit 478 të KPC-së ajo gjykatë duhej t'i komunikonte atij këto dy vendime. Në kushtet kur shkaku determinant ishin vendimet gjyqësore të juridiksionit penal, mosgjyrimi i tyre në seancë gjyqësore në prani të palëve përbën një tjetër shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, një tjetër argument lidhur me cenimin e parimit të “gjësë së gjykuar” është edhe fakti se Gjykata e Lartë duhet ta prishte vendimin vetëm për rekursuesit S.V. dhe D.V. dhe jo për të gjithë të paditurit, të cilët nuk kanë ushtruar rekurs.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion subsidiar, ai mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji eidenton se objekti i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore, për shkak të nevojës për hetimin dhe vlerësimin e disa rrethanave të pashqyrtuara plotësisht nga gjykatat e faktit.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk

vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuksi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tilla me natyrë jopërfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në të tilla raste, kërkuksi duhet të provojë se shkelja e pretenduar në rastin konkret është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pasi ajo dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Kolegji fillimisht, vëren se me vendimin objekt kundërshtimi të Gjykatës së Lartë ka përfunduar gjykimi në atë shkallë, por jo procesi gjyqësor, i cili, sipas urdhërimit të asaj gjykate, duhet të ribëhet edhe një herë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kërkuksi, për gjykimin në Gjykatë të Lartë ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Kolegji konstaton se për nga natyra e tyre këto pretendime të ngritura nga kërkuksi mund të shqyrtohen dhe të sqarohen gjatë rigjyimit të çështjes në gjykatën e apelit, duke marrë përgjigje prej saj në ushtrim të juridiksionit të asaj gjykate. Konkretisht, ndër detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është edhe të administrojë dhe të vlerësojë natyrën e vendimeve të gjykatave të faktit për pushimin e çështjes penale, si dhe faktin nëse këto vendimmarrje kanë ose jo relevancë për çështjen objekt gjykimi. Në këtë kontekst, në ndryshim nga sa pretendon kërkuksi, rezulton se Gjykata e Lartë analizën e këtyre vendimeve ia ka lënë gjykatës së apelit, duke i dhënë mundësi kërkuksit të mbrohet dhe të debatojë mbi këto fakte. Ndërkohë, arsyet e kthimit të çështjes për rigjykim lidhen, ndër të tjera, edhe me shkeljen procedurale të mosmarrjes në analizë të kundërpadsisë nga ana e Gjykatës së apelit, si dhe me faktin nëse titulli i pronësisë ishte i ligjshëm ose jo dhe nëse kërkuksi kishte pasur apo jo të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve.

16. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuksi nuk ka arritur të provojë se shkeljet e pretenduara në rastin konkret janë të tilla që të justifikojnë shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues duke mos u gjendur përpara rastit përjashtimor. Në këtë kuptim, rezulton se kërkuksi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

17. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

18. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.